

Prind ose kujdestar i dashur:

Gjatë pranverës 2013, shkollat anembanë Michigan administrojnë Testin shtetëror Vlerësimi i aftësisë së zotërimit të gjuhës angleze (English Language Proficiency Assessment, ELPA). Akti federal i vitit 2001 i titulluar “Jo Fëmijë të lënë mënjanë”(No Child Left Behind, NCLB) kërkon që shkollat të bëjnë nëpërmjet një testi vlerësimin e aftësive në gjuhën angleze për të gjithë studentët nga Kopshti deri në vitin e fundit të shkollës së mesme K-12, nëpërmjet këtij vlerësimi tregohet përparimin i tyre në mësimin si dhe aftësitë në gjuhën angleze.(Për më shumë informacion mund të gjeni në faqen e internetit www.michigan.gov/elpa.)

ELPA apo(vlerësimi i aftësisë së zotërimit të gjuhës angleze) mat atë që një student duhet të zotëroj dhe të jenë në gjendje të bëjnë në përdorimin e gjuhës angleze. Rezultatet e paraqitura në këtë raport tregojnë se sa nivelin e paraqitur nga nxënësi në fushat e dëgjimit, leximit, shkrimit, të folurit, dhe të kuptuarit. Nëse studenti juaj mori të gjitha pjesët e ELPA-s apo(vlerësimi i aftësisë së zotërimit të gjuhës angleze), një nivel të përgjithshëm të arritjes është i përfshirë në rezultatin përfundimtar.

Rezultatet e nxënësit në ELPA apo(vlerësimi i aftësisë së zotërimit të gjuhës angleze) është raportuar në një nga pesë nivelet: bazë ose themelor, mesatar i ulët, mesatar i lartë, i aftë dhe i aftë i avancuar. Përshkrimet e këtyre niveleve të arritura janë të përfshira në anën e kundërt të kësaj faqeje.

Ne ju inkurajojmë që të diskutoni rezultatet e ELPA-s apo (vlerësimi i aftësisë së zotërimit të gjuhës angleze) me mësuesit e nxënësit tuaj si dhe personelin e specializuar nga shkolla të cilët kanë pasur mundësinë të njohin studentin tuaj nga afër. Prindërit / kujdestarët dhe mësuesit kanë një mundësi shumë më të madhe për të ndihmuar studentët të kenë sukses kur ata punojnë së bashku për të frymëzuar dhe mbështetur arritjet e tyre.

Sinqerisht

Mike Flanagan
Inspektor i Shtetit
Departamenti i Arsimit të Michigan